



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

RAPORTI VJETOR

2016



Të jetojmë nga toka dhe puna jonë

Fjala e drejtorit të IADK-së

Me qëllim të informimit, ngritjes së transparencës, komunikimit dhe llogaridhënies, IADK edhe këtë vit publikon raportin vjetor për të informuar donatorët, partnerët, fermerët dhe të gjithë të interesuarit të tjerë për përparimin që kemi bërë drejt arritjes së qëllimeve tona strategjike në kontributin dhënë zhvillimit të bujqësisë në Kosovë.

Ne duar keni një raport përmbledhës të shume aktiviteteve dhe rezultateve të arritura të punonjëseve të IADK së bashku me partneret e saj që ka arritur gjatë vitit që po lemë pas.

Bujqësia në Kosovë ka marrë një drejtim tjetër të zhvillimit sepse është duke u konsideruar si biznes profitabil dhe sektor ku mund të hapen vende pune. Shume biznese që konsiderohen një në sektor tjetër janë duke hyre në sektorin e bujqësisë me ambicieje të mëdha që do të kenë sukses edhe në bujqësi. Ne mendoj që këtu duhet pasur kujdes sepse bujqësia nuk është sektor i lehtë i cili mund të zhvillohet nga zyra ose vetëm nga një biznes plan por, bujqësi është diçka më tepër, ku kërkohet me shume pune dhe angazhim ditor, njohuri të ndryshme profesionale prandaj keni shumë kujdes sepse mund të dështojë!

Tani fermerët dhe bizneset që merren me bujqësi duhet të fokusohen në sektor ku do të punojnë!

Në përmbyllëm me sukses tri projektet, të cilat kanë pasur periudhë dyvjeçare të zbatimit: "Gjenerimi i të ardhurave dhe aktivitet trajnuese për grupet e marginalizuara dhe fermerët në zonat rurale", "Mbështetja e prodhimit vendor në Rajonin e komunave veriore në Mitrovicë dhe rajonin Ekonomik Jug" dhe "Fuqizimi

Ekonomik dhe ndërtimi i kapaciteteve të grave të veja në regjionin e Mitrovicës dhe Prishtinës".

Të tri këto projekte kanë pas një efekt shumë të madh; në përmirësimin e jetës së familjeve të përfshira si përfituese të aktiviteteve të ndryshme të projekteve; janë përkrahur një target grupet e ndjeshme të shoqërisë gratë kryefamiljare të cilat kanë jetuar në kushte të renda, pa të adhurua si të pa përfshira në shoqëri.

Këto projekte si dhe të tjera që ne po zbatojmë janë duke bërë ndryshime në jetën e njësive!

IADK do të vazhdojë me përkushtim, pasion, dëshirë dhe ambicie për të arritur sa më shumë rezultate, për të qenë më pranë fermerëve dhe institucioneve duke i mbështetur ato në zhvillimin e bujqësisë.

Nëfund në emër tim, të Bordit të Drejtoreve dhe të punonjësve, do të doja të falënderojmë të gjithë ata që ndër vite kanë bërë të mundur suksesin e organizatës së IADK-së, si; fermerë dhe partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakursyer të tyre në rrugëtimin e përbashkët.

Zenel Bunjaku

TË ARRITURAT NË VITIN 2016

- **Me shume familje të përkrahura në mënyrë direkte**

197 ekonomi familjare janë përkrahur direkt nga programet e IADK. Aktivitet në të cilat janë përkrahur familjet janë: (serra për kultivim të perimeve, serra për tharje të bimëve mjekësore, fidanë dhe inpute për dredhëz, mjedërs dhe bimëve mjekësore, kultivimi i specit në fushë të hapur, depo druri për kompost, pako higjienike përpërmirësimin e kualitetit të qumështit, pajisje për përpunimin e qumështit, panele solare për prodhimin e energjisë, ndërtimin e depos se plehut, makina mjelëse për lopë, koshere për bletë për prodhimtarin organike dhe pajisje të kuzhinave për përgatitjen e ushqimit).

- **Ngritja e kapacitetëve njerzore në sektorin e bujqësisë**

Gjatë vitit 2016, IADK rendësi të veçantë i ka kushtuar edukimit dhe rritjes së kapaciteteve njerzore në sektorin e bujqësisë. 3976 fermerë, studentë, inxhinier të bujqësisë dhe punëtorë institucional janë trajnuar në 385 sesione të trajnimeve. Trajnimet kanë përfshirë të gjithë sektorët e bujqësisë.

- **Shkëmbimi i përvojave**

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave me vendet dhe organizatat e ndryshme, gjatë këtij viti, IADK ka organizuar 18 vizita në vend, regjion dhe në vendet e BE ku kanë marr pjesë 137 pjesëmarrës.

- **Më shumë vende punë të krijuara**

Bizneset, fermerët e përkrahur nga IADK kanë krijuar mundësi për vetëpunësim dhe punësim për anëtarë të familjes apo individë të komunitetit ku jetojnë klientët tanë. Gjatë këtij viti IADK ka ngritur 0.17 hasipërfaqe me serra

për kultivim të perimeve, 450 m² me serra tharëse, 1.6 ha në kultivimin e bimëve mjekësore, 6.9 ha sipërfaqe në kultivimin e mjedërs dhe 0.8 ha sipërfaqe në kultivimin e dredhëzës, në sektorin e përpunimit të qumështit janë përkrahur 7 pika përpunuese të qumështit të lopës dhe dhisë.

- **Zgjerim i mëtejshëm në të gjithë vendin**

Numri i fermerëve të përkrahur për çdo vit është në rritje, çka përbën një bazë të mirë dhe garanci për arritje afatgjate. IADK tani me ka shtrirje të aktiviteteve në të gjitha Komunat e Kosovës

- **Procedura dhe procese të shpejta dhe transparente**

Përzgjedhja e përfituesve, dhe transparenca e gjithë procesit kanë rëndësi për ne. IADK aplikon procesin e përzgjedhjes së përfituesve me anë të poentimit, çka bën të mundur marrjen e vendimit dhe procesin e përzgjedhjes brenda një kohe të shkurtër, transparent dhe pa vonesa.

PARTNERET DHE DONATORET E IADK-së GJATË VITIT 2016

Gjatë këtij viti IADK ka vazhduar bashkëpunimin me donatorët me të cilët është krijuar një partneritet afatgjatë në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë. Po ashtu në vitin 2016 IADK ka arritur të krijoj besimin edhe të donatorëve të rinjë në implementimin e projekteve të përbashkëta me qëllim të arritjes së objektivave tona në zhvillimin bujqësisë në Kosovë.

Donatorët e projekteve të përkrahura gjatë vitit 2016 janë:

- **BrotfürdieWelt (BfdW)** Projekti: “Gjenerimin e të ardhurave dhe aktivitet trajnuese për grupet e marginalizuara dhe fermerët në zonat rurale”
- **Bashkimi Evropian** “Fuqizimin ekonomik dhe ngritjen e kapaciteteve të grave të veja në regjionin e Mitrovicës dhe Prishtinës”
- **Bashkimi Evropian** “Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të zi”
- **UNDP** “Mbështetja e prodhimit vendës në komunat veriore të Rajonit të Mitrovicës dhe Rajonin Ekonomik Jug”
- **Ambasada Kanadeze** “Krijimi i kushteve të punës në viset rurale dhe rritja e bashkëpunimit në mes të komuniteteve”
- **HELP** ka kontraktuar IADK-në për ofrimin e shërbimeve këshillimore për klientët të cilët i ka përkrah me pajisje apo mjete për aktivitete bujqësore.
- **GIZ-i** po ashtu ka kontraktuar IADK-në për

mbajtjen e trajnimeve për aftësitë në biznes dhe zhvillim të produktit

- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)** “Promovimi i kultivimit të mjedrës, mollës, dredhëzës dhe përmirësimi i kualitetit të qumështit”

- **“Laboratori për Aktivitete të Biznesit” (LAB)**, nga Hani i Elezit në kryerjen e shërbimeve profesionale për fermerë, në sektorin e bujqësisë dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për stafin e LAB-it

- Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe përkrahja direkte e fermerëve me Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës, Drenasit si dhe fillimi i bashkëpunimit edhe me Komunën e Vitisë dhe Deçani

Bashkëpunimi me organizatat me **Ekspertët Senior nga Holanda (PUM)** dhe me **Shoqatën e Fermerëve nga Normandia e Ulët e Francës (AFDI)** - ngritja e kapaciteteve të stafit të IADK-së dhe promovimit të praktikave të reja në sektorin e bujqësisë



DEPARTAMENTI I HORTIKULTURËS

Edhe këtë vit në kuadër të projekteve të shumta të financuara nga donatorë të ndryshëm IADK ka mbështetur fermerët në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe profesionale në fusha të ndryshme në hortikulturë dhe në sektorin e bimëve aromatike e mjekësore. Fushat kryesore të investimeve të kryera për fermerët përfshijnë ndërtimin e serrave, ngritjen e pemishteve me fruta të imëta (dredhëz, mjedër), si dhe plantacionet me bimë aromatike e mjekësore.

Serrat me sipërfaqe prej 200 m²

Në këtë aktivitet janë mbështetur 5 fermer për ngritjen e serrave prej 200 m² për prodhimin e perimeve. Dy prej tyre janë nga Rahoveci, një nga Malisheva dhe një nga Leposaviqi. Të gjithë përfituesit janë furnizuar me nga 600 fidane të perimeve dhe me paketën përcjellëse të inputeve. Si rezultat i kultivimit të perimeve në këto 5 serra, janë përfituar të ardhura të përgjithshme në vlerë prej 8,633 €, ndërsa sasia totale e prodhimit është afërsisht 20,490 kg.


Nëse të hyrat e përgjithshme ndahen për numrin e serrave, e shohim se të ardhurat mesatare për serrë prej 200 m² janë përafërsisht 1,726 €.

Pas heqjes perimeve kryesore, serrat janë mbjellë me perime vjeshtore dhe në

këtë mënyrë fermerët do të kenë të ardhurat shtesë nga kultivimin i dytë i perimeve si janë sallata, qepë, spinaqetj. Ky vit ka qenë më i favorshëm sa i përket shitjes dhe çmimeve të perimeve dhe fermerët janë të kënaqur me të ardhurat e arritura.

Serrat me sipërfaqe prej 100 m²

Përfitues të serrave prej 100 m², paketa përkrahëse dhe nga 300 fidanë perimesh janë 7 fermerë nga komunat veriore në rajonin e Mitrovicës. Si rezultat i kultivimit të perimeve në këto serra, janë përfituar të ardhura të përgjithshme në vlerë prej 5,386 €, ndërsa sasia totale e prodhimit është afërsisht 8,325 kg.



Kultivimi i dredhëzave

Për kultivim të dredhëzave janë mbështetur 8 fermerët , të cilët kanë ngrit pemishte të dredhëzës me sipërfaqe nga 1000 m². Përfituesit janë furnizuar me nga 5000 fidane të dredhëzave të cilësisë së lartë ("frigo"), importuara nga Italia dhe inpute përcjellëse. Përfituesit e pemishteve me dredhëza janë udhëzuar për të gjitha praktikat e kultivimit, dhe po ashtu në sajë edhe të kushteve klimatike favorizuese për këtë kulturë, ka pasur një rritje dhe zhvillim shumë të mirë të dredhëzave. Në dy tri vitet e ardhshme pritet që prodhimi mesatar nga secila ngastër të jetë afërsisht nga 3 tonë/1000 m².



Kultivimi i mjedrave

Në këtë aktivitet janë mbështetur 62 fermerë për ngritjen e pemishteve me mjedër në sipërfaqe me nga 1000 m². Përfituesit kanë marrë nga 1000 fidanë të mjedrave, si dhe pakon përcjellëse me inpute të nevojshme për këtë aktivitet.. Ngritja e këtyre pemishteve është një investim i rëndësishëm për fermerët përfitues, ngase do të krijojnë hyra afatgjate për për së paku 15 vite, me të hyra mesatare të pritshme vjetore nga 2500-3000 €. Po ashtu fermerët kanë përfituar njohuritë bazike për kultivim dhe zgjerim të sipërfaqeve prodhuese me këtë bimë mjaft fitimprurëse.



Kultivimi i rignonit të bardhë

Në këtë aktivitet janë të mbështetur gjithësej 10 fermer, prej tyre 6 fermer për krijimin e parcelave me sipërfaqe prej 2000 m², dhe 4 fermerë me sipërfaqe me nga 1000 m² për kultivim të rignonit të bardhë. Fermerët kanë përfituar pakon mbështetëse e cila përmban:

- Fidanët e rignonit të bardhë;
- Sistemin komplet të ujitjes pikë-pikë
- Nga një serrë tharëse prej 50m² për tharjen e rignonit pas kositjes



Rigoni është një bimë pesë deri shtatë vjeçare e cila nuk kërkon shpenzime gjatë vegetacionit, përveç mirëmbajtjes së tokës nga barojat e këqija, ujitjen gjatë periudhave me thatësi dhe kositjen e tharjen e masës bimore. Gjatë këtij viti është bërë përgatitja e ngastrave dhe e bimëve të rigonit për të dhënë prodhimin në 5-6 vitet e ardhshme, i cili do të jetë burim i mirë për krijimin e të hyrave për ekonominë familjare të përfituesve. Me nga një serrë tharëse janë përkrahur edhe 4 përfitues të rigonit të kuq, të cilët në vitin e kaluar kanë marrë vetëm fidanët e rigonit dhe sistemin e ujitjes, dhe kishin vështirësi për tharjen e masës bimore pas kositjes.

Kultivimi i specit në fushë të hapur

Në këtë aktivitet janë përkrahur 10 fermerë në kultivimin e specit në fushë të hapur, në ngastra me sipërfaqe nga 1000 m². Prej tyre pesë fermerë janë nga Vushtrria, tre nga Drenasi dhe dy nga Mitrovica. Për secilin prej tyre janë



siguruar farërat e specit të kultivarit "AMY", pastaj sistemi i ujitjes pikë-pikë, si dhe shërbimet këshillimore për të gjitha praktikatat e kultivimit të specit. Ky kultivar viteve të fundit ka një përhapje bukur të madhe në rajone të ndryshme të vendit tonë, dhe ka potencial të lartë prodhues e cilësi të mirë të frutave. Megjithatë kultivimi i tij ka pasur rezultate më të mira në toka të lehta dhe

të plehëruara me pleh organik, në krahasim me kultivimin e tij në toka të rënda. Nga të dhënat e marra nga të gjithë përfituesit është nxjerrë mesatarja e prodhimit për sipërfaqen prej 10 ari, e cila është 1605 kg, ndërsa të hyrat mesatare për përfitues janë afër 610 €.

Promovimi i prodhimit organik të mjedrave

Në këtë komponentë janë trajnuar 20 fermerë për praktikatat e kultivimit të mjedrës në mënyrë organike, ndërsa prej 7 tyre janë përkrahur në mënyrë direkte për ngritje të pemishteve për kultivim të mjedrës në mënyrë organike. Ata janë përkrahur me një pako për ngritje të



plantacioneve të mjedrës në sipërfaqe prej 1000 m², e cila përmban: 1000 fidanë mjedre, sistemin e ujitjes pikë-pikë, sistemi mbështetës, një broshurë për kultivim të mjedrës, si dhe ofrimin e trajnimeve dhe këshillave praktike në teren gjatë ngritjes së pemishteve. Fermerët e përkrahur janë nga komunat Vushtrria (3), Mitrovicë (1), Drenas (1), Zubin Potok (1) dhe Leposaviq (1). Me sistem mbështetës janë përkrahur edhe 4 fermerë përfitues të vitit të kaluar me aktivitet të ngjashëm.

Po ashtu fermerët janë përkrahur me paketime për vendosjen e mjedrave, etiketa ngjitëse në paketime si dhe fletushka në të cilat është përshkruar rëndësia dhe dallimi mes bujqësisë konvencionale dhe asaj organik

Për promovim të kultivimit të mjedrave në rajonin verior, IADK në bashkëpunim edhe me Komunën e Zubin Potokut, ka organizuar “Ditën e Mjadrës”, me synim që ky organizim të jetë tradicional, dhe të ndihmojë fermerët e kësaj zone për të promovuar cilësinë e mjedrave tek konsumatorët dhe kompanitë grumbulluese dhe eksportuese të këtyre frutave të imëta, por me vlerë të lartë dhe shumë profitabile.




Po ashtu me qëllim të avancimit të njohurive profesionale, ngritjes së kapaciteteve prodhuese dhe qasjes më të lehtë në donacione, kultivuesit e mjedrave në Komunën e Zubin Potokut janë përkrahur për të themeluar një organiztë jo qeveritare në të cilën janë përfshirë fermerët që janë duke kultivuar, apo kanë në planë të merren me kultivim të mjadrës. Grupi i fermerëve janë trajnuar për rëndësinë dhe format e organizimit të fermerëve, procedurat për regjistrim, dhe për rëndësinë dhe benifitet që mund të kenë në të ardhmen fermerët e organizuar në shoqatë apo grupim tjetër të përbashkët.

Për lehtësim të punës IADK për shoqatën e themeluar ka ndihmuar gjatë regjistrimit, si dhe ka furnizuar me inventar për zyre, si janë: kompjuter, printer, tavolina pune, karrika, folldera etj.

Orientimi i fermerëve në prodhimin organik të perimeve

Në kuadër të këtij aktiviteti që ka filluar në vitin e kaluar, ku janë dhënë trajnimet bazike për konceptin e bujqësisë organike, për 5 grupe të fermerëve në pesë komuna (Podujevë, Vushtrri, Mitrovicë, Drenas dhe Malishevë), këtë vit është

vazhduar me aplikimin e këtyre praktikave të bujqësisë organike në teren, dhe avancimi i njohurive të pesë grupeve të fermerëve për kultivimin e domateve në mënyrë organike. fermerët kanë ndjekur trajnimet, me fidanë të domateve dhe disa inpute të nevojshme dhe të lejueshme për përdorim në bujqësinë organike. Pakoja përkrahëse me të cilën është furnizuar secili fermer përfshinë; 600 fidanë të domatës, foljen e zezë për mulqirim të tokës në serrë, 1000 litra kompost organik, 100 m² rrjetë antiinsekt për vendosje në dritaret anësore të serrës me qëllim të pengimit të hyrjes së insekteve në serrë, si dhe stikerat/shirtitat ngjitës për kapje të insekteve të cilat mund të kenë depërtuar brenda serrës.



Përveç inputeve të lartcekura dhe trajnimeve e këshillave të ofruara, fermerët janë përkrahur edhe nga aspekti i marketingut për të promovuar benifitet e prodhimit organikë bujqësorë tek konsumatorët. Kjo është bërë duke i furnizuar të pesë përfituesit me 400 arka të drurit për vendosjen e domateve, si dhe etiketa ngjitëse për arka.

Kompostimi dhe substrati

Për të përfituar njohuri rreth procesit të kompostimit të mbeturinave bimore, IADK edhe këtë vit ka mbajtur trajnime për ofrimin e njohurive bazike për konceptin e procesit të kompostimit të mbeturinave bimore me dy grupe të fermerëve; Mitrovicë dhe Skenderaj. Prej dy grupeve që kanë ndjekur trajnimet për kompostim, është përkrahur nga një fermerë me nga një kompostatë të drurit me vëllim prej 3 m³, për të vendosur mbeturinat bimore me qëllim të përfitimit të kompostit organik, dhe mbrojtjes së ambientit.



DEPARTAMENTI I BLEGTORISË

Prodhimtaria organike e mjaltit

Gjatë vitit 2016, IADK ka vazhduar të përkrahë sektorin e bletarisë në prodhimtarinë organike të mjaltit. Gjatë këtij viti, IADK ka trajnuar dy grupe të bletarëve nga Komuna e Mitrovicës, Skenderajt dhe Drenasit lidhur me procedurat për konvertim në prodhimtarinë organike, standardet dhe kushtet për konvertim. Trajnimet i kanë ndjekur 26 bletarë dhe në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit kanë marrë njohuritë e duhura për konvertim në prodhimtarinë organike të mjaltit. Nga grupi i pjesëmarrësve në trajnim, IADK ka përzgjedhë dy bletarë ku secili është përkrahur me 20 koshere për bletë të cilat i plotësojnë standardet dhe janë të ndërtuara nga materiali i cili lejohet në prodhimtarinë organike.

Menaxhimi i plehut në fermë dhe ruajtja e ambientit

Me qëllim të uljes së ndotjes dhe përmirimit të menaxhimit sa më të mirë të plehut të stalles, IADK gjatë vitit 2016 ka vazhduar me trajnimin e fermerëve në këtë lëmi. Trajnimet i kanë ndjekur 4 grupe të fermerëve nga Komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës,



Skenderajt dhe Drenasit. Secili grup ka pasur nga 15 fermerë ku në total janë trajnuar 60 fermerë në 5 sesionetë trajnimit. Për të demonstruar praktikat e mira të menaxhimit të plehrave, IADK gjatë këtij viti ka përkrahur një fermerë për rregullimin e gropës septike për grumbullimin e plehut me kapacitet prej 125



Iadk akreditohet nga autoriteti kombëtar i kualifikimeve

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK është e angazhuar për zhvillimin e bujqësisë dhe ngritjen e aftësisë profesionale në fushën e bujqësisë. Për të siguruar të rinjtë dhe të rriturit të marrin kualifikime që do të njihen si ekuivalente me ato të dhëna nga institucionet tjera në vend dhe jashtë vendit, IADK është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve –AKK për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimin në sektorin e blegtorisë. Pjesëmarrësit në këto trajnime do të certifikohen si Teknik i Blegtorisë, niveli i III sipas AKK.

Akreditimi vlen për periudhën 14.12.2015 deri me 14.12.2018. Gjatë kësaj periudhe IADK do të formojë grupet e fermerëve për të trajnuar në sektorin e blegtorisë.

Pjesëmarrësit të cilët do të ndjekin trajnimet do

të certifikohen e cila certifikatë është valide dhe e njohur nga të gjitha institucionet e vendit. Pas përfundimit me sukses të këtij profili, pjesëmarrësit përgatitën për të fituar kualifikim profesional që u mundëson atyre integrimin në tregun e punës për Teknik të blegtorisë, si dhe vazhdimin e arsimimit në nivele më të larta.



Vizita studimore me fermer në Kosovë

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave në mes të fermerëve është organizuar një vizitë studimore me fermerët të cilët merren me rritjen e dhive.

Në vizitë kanë marrë pjesë 16 fermerë ku është vizituar qumështorja "MATI" në Malishevë e cila përpunon qumështin e dhisë. Vizita e dytë me të njetin grup është realizuar në Suharekë ku pjesëmarrësit kanë vizituar një fermerë të dhive.

Pas trajnimit dhe lëshimit në funksion të pajisjeve, përfituesit kanë filluar në prodhimin e llojeve të djathërave. Pas futjes në prodhim të pajisjeve dhe trajnimit të stafit të pikave përpunuese të djathit të dhisë është arritur të ulet kostoja e prodhimit të djathërave. Me qëllim të promovimit të prodhimeve të qumështit të dhisë të dy pikat përpunuese janë përkrahur në përgatitjen e logove dhe etiketave për lloje të ndryshme të produkteve nga qumështi i dhisë.

Në kuadër të këtij projekti po ashtu janë trajnuar dy grupe të fermerëve nga komuniteti shqiptarë dhe serb. Secili grup ka ndjekur nga 5 sesionetë trajnimit në menaxhimin fermave të dhive. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve nga Mitrovica ka qenë 31 pjesëmarrës ndërsa nga Zveçani 28 pjesëmarrës.



Rritja e bashkëpunimit në mes të komuniteteve Me qëllim të krijimit të kushteve të punës në viset rural dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të komuniteteve me përkrahjen e Ambasadës Kanadeze janë përkrahur dy fermerë të dhive me pajisje për përpunimin e qumështit të dhisë. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është rritja e kapaciteteve përpunuese të qumështit të dhisë, përmirësimi i kualitetit të produkteve të qumështit, rritjen e vlerës së produkteve finale dhe rritjen e bashkëpunimit në mes komuniteteve.

Pikat përpunuese të qumështit të dhisë janë përkrahur një në Komunën e Mitrovicës dhe një në Komunën e Zveçanit dhe janë pajisur me të gjitha pajisjet për përpunimin e qumështit me një kapacitet prej 500 litrash.

Duke pasur parasysh mungesën e përvojës në përpunimin e qumështit të dhisë, IADK ka bërë trajnimin e stafit të pikave përpunuese në përpunimin e llojeve të ndryshme të djathërave.



Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi

Në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi" dhe menaxhuar nga IADK, janë zbatuar aktivitete me qëllim të krijimit të kushteve dhe promovimit të turizmit rural në Komunën e Deçanit dhe Junikut. Projekti ka filluar të zbatohet në vitin 2016 dhe do të përfundojë në vitin 2017. Në këtë raport janë paraqitur aktivitete të realizuara në vitin 2016. Aktivitetet janë të përfshira në katër komponente më kryesore, siç janë:

1. Promovimi i zhvillimit të turizmit rural në zonën ndërkufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi
2. Ndërtimi i qendrës informuese për turistët
3. Ndërtimi i shtegut për këmbësorë dhe shënjimi i tij
4. Krijimi i kushteve për ofrimin e shërbimeve për turistët

Ndërtimi i shtegut për këmbësor

Në kuadër të projektit për zhvillimin e turizmit rural është ndërtuar shtegu për këmbësorë. Shtegu shtrihet në një gjatësi prej 13 km dhe fillon nga bjeshka e Belegut dhe lidhë Majën e Bogiqit në kufi me Malin e Zi dhe bjeshkën e Roshkodolit. 10 km të shtegut janë trajtuar ku janë ndërtuar edhe dy ura nga druri për qasje me të letë për këmbësorët. Në kuadër të shtegut janë vendosur edhe 42 shenja për orientimin e këmbësorëve dhe identifikimin e zonave për turistët. Shtegu vizitohet rregullisht nga turistët të cilët edhe shijojnë peizazhet e bukura të zonës gjatë kohës së verës.

Shtegu për këmbësorë që lidhë bjeshkët e Belegut, majën e Bogiqit dhe bjeshkën e Roshkodolit

Ndërtimi i kampingjeve dhe vend pushimeve për turistët

Në kuadër të këtij aktiviteti janë ndërtuar 5

kampingje dhe 5 vend pushimorë për turistët për gjatë shtegut të këmbësorëve në bjeshkët e Belegut dhe Roshkodolit. Kampingjet dhe vend pushimorët janë të dizajnuar dhe projektuar në bazë të konceptit tradicional dhe janë të ndërtuar nga druri që i përshtatet ambientit malor.



Kampingjet dhe vend pushimoret ofrojnë vend shumë të përshtatshme për të pushuar dhe për marrjen ushqimit për turistët që i vizitojnë këto bjeshkë dhe janë atraksion për vizitorët.

Vend pushimet dhe kampingjet për vizitorët në bjeshkët e Belegut dhe Roshkodolit.



Vend ushqimet për kafshët e egra

Me qëllim të ruajtjes dhe kujdesit ndaj kafshëve të egra me anë të projektit janë ndërtuar 5 vend ushqime për kafshët e egra. Këto vend ushqime do të pajisjen me ushqim gjatë kohës së dimrit dhe do të shërbejnë si vend ushqime për kafshët e egra. Me rritjen e numrit të kafshëve të egra në këto zona do të krijohet atraksion për turistët për të parë lloje të ndryshme të kafshëve të egra të cilat gjenden në këto bjeshkë.

Vend ushqimet për kafshët e egra



Vend ushqimet për kafshët e egra



Përkrahja e fermerëve me pajisje për përpunimin e qumështit dhe paneleve solar për prodhimin e energjisë

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për përpunimin e qumështit në stane/bjeshkë dhe përmirësimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve për turizëm rural janë përkrahur 5 fermerë me pajisje për përpunimin e qumështit dhe 5 me panele solare. Në kuadër të pajisjeve të qumështit fermerët janë përkrahur me duplikator për pasterizimin e qumështit, vaska e djathit, tavolina të punës, kallpët e djathit rafte për djathë, pajisje për ruajtje dhe transport të qumështit dhe pajisje tjera për përpunimin e qumështit. Ndërsa në kuadër të pajisjeve për prodhimin e energjisë fermerët janë përkrahur me panele solare për prodhimin e 1 KW energji.

Po ashtu përfituesit janë përkrahur edhe me investime shtesë në përmirësimin e infrastrukturës së pikave përpunuese të djathit. Me anë të këtij aktiviteti fermerëve u janë krijuar kushtet për ofrimin e shërbimeve për turistët, është rritur siguria dhe kualiteti i prodhimeve të qumështit. Gjatë vitit tjetër rreth 50 fermerë do të trajnohen në përpunimin e qumështit në lloje të ndryshme të djathërave.

Pajisjet për përpunimin e qumështit dhe panelet solare



Trajnimet për familjet mikpritëse dhe restorantet për shërbimet turistike

Në mënyrë që të përmirësohen shërbimet e turizmit nga familjet mikpritëse dhe restorantet në zonën e Deçanit dhe Junikut janë duke mbajtur trajnimet për ngritjen e shërbimeve për turistët. Në kuadër të këtij aktiviteti do të

formohen 5 grupe dhe do të ndjekin 3 sesionetë trajnimit secili grup. Trajnimet me grupin e parë kanë përfunduar ku janë trajnuar 15 pjesëmarrës.



Organizimi i ditëve tradicionale me qëllim të promovimit të turizmit rural

Me qëllim të promovimit të trashëgimisë kulturore të zonës së Dukagjinit janë organizuar tri ditë tradicionale.

“Dita e Qethjes së Deleve” është organizuar në bjeshkët e Isniqit ku kanë marrë pjesë 78 pjesëmarrës. Gjatë kësaj dite janë organizuar garat e qethjes së deleve dhe janë përzgjedhur qethtarët më të mirë.

“Dita e Gështenjës” është organizuar në Komunën e Deçanit dhe kanë marrë pjesë 66 pjesëmarrës, si prodhues të fidanëve të gështenjës dhe grumbullues të gështenjës. Ngjarja është transmetuar në mjetetë informimit dhe ka pas karakter promovues.



“Darka e Lamës”, është një organizim i veçant që është mbajtur me qëllim të promovimit të turizmit dhe vlerave tradicionale që ofron zona e Dukagjinit. Kjo është një festë tradicionale shqiptare dhe zakonisht mbahet në fund të sezonit kur janë vjelë të mirat e punës verore. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë 61 pjesëmarrës. Në këtë ngjarje janë përzgjedhur fermeret të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe promovimit të turizmit rural në Komunën e Deçanit dhe Junikut ku janë ndarë 4 mirënjohje:

Për kontributin e dhënë në zhvillimin e turizmit rural, për kontributin e dhënë në zhvillimin e sektorit të qumështit të lopës, për kontributin e dhënë në zhvillimin e sektorit të deleve, për kontributin e dhënë në përpunimin e djathit tradicional

DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Fuqizimi ekonomik i grave në viset rurale

Duke i parë vështirësitë e grave në viset rurale dhe grave kryefamiljare, IADK gjatë këtij viti i ka dhënë prioritet këtij grupi me qëllim të krijimit të kushteve me të mira dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Për të arritur këtë qëllim, IADK gjatë këtij viti ka trajnuar grupet e grave në përgatitjen e ushqimit për nxënësit e shkollave. Në kuadër të këtij aktiviteti janë trajnuar 97 gra në përgatitjen e ushqimeve të ndryshme për nxënësit e shkollave në 7-10 sesione të trajnimeve. Pas përfundimit të trajnimit, gratë kanë marrë njohuri të mjaftueshme në përgatitjen e 8 llojeve të ndryshme të ushqimeve. Po ashtu grupet e grave kanë ndjekur trajnime në aspektin ekonomik për mënyrën e menaxhimit sa më të mirë të bufeve.

Krijimi i tetë bufeve në shkolla

Mbas përfundimit të trajnimeve për përgatitjen e ushqimit dhe trajnimeve ekonomike se bashku me zyrat komunale të punësimit janë përzgjedhur 33 gra të cilat janë punësuar në 8 bufet e krijuara. Së bashku me drejtorit e Arsimit të komunave Mitrovicë, Vushtrri, Drenas, Skenderaj dhe Viti, janë përzgjedhur 8 shkollat ku janë krijuar bufet, siç janë:

1. SHFMU “FazliGrajqevci” Mitrovicë
2. SHMU “MustafëVenhari” Vushtrri
3. SHFMU “AbedinRexha” Skënderaj
4. SHFMU “Xheladin Gashi - Plaku” Komoran, Drenas
5. SHFMU “Shotë Galica” Skënderaj
6. SHFMU “Rilindja” Maxhunaj, Vushtrri
7. SHFMU “Bafti Haxhiu” Viti dhe
8. SHFMU “Dëshmorët e Vitise”, Viti.





Mbas përzgjedhjes IADK ka ndihmuar në renovimin e hapësirave të përcaktuara për bufe dhe janë pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për funksionalizimin e bufeve. Me fillimin e vitit shkollor është bërë edhe funksionalizimi i bufeve, ku janë punësuar 33 gra në përgatitjen e ushqimit për nxënësit e këtyre shkollave, përafërsisht 7300 nxënës dhe staf i shkollës ushqehen në këto bufe. Secila nga këto 33 gra arrijnë të krijojnë të ardhura mujore në vlerë mesatare prej 250 – 500 € varësisht nga numri i nxënësve në shkollat e përzgjedhura.

Iadk përkrahë grupet e grave për regjistrim të bizneseve

Gratë pjesëmarrëse në trajnimet e organizuara nga IADK, të cilat tani janë punësuar në 15 bufet e krijuara nga IADK gjatë vitit 2015-2016, tani më edhe janë legalizuar në forma të ndryshme të regjistrimit.

Janë krijuar dy biznese, një kooperativë dhe tetë OJQ, në Komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderajt dhe Drenasit. IADK ka mbështetur grupet e interesuara me trajnimet me lëndët: funksionimin e bizneseve, kooperativave, shoqatave dhe ka lehtësuar të gjithë procesin e regjistrimit të tyre, duke përmbyshur dokumentet për regjistrim, krijimin e logos dhe orientimin e grave në vendet e regjistrimit.



1. Trajnimet në modulën e pemëve dhe perimeve

Në këto module janë trajnuar një grup i grave me gjithsej 28 gra nga fshati Sllatinë dhe Lubishtë, Komuna e Vitisë. Këto module kanë përmbajtur nga 10 sesione të trajnimeve gjithsejtë 20 sesion ku gratë janë trajnuar në përpunimin e llojeve të ndryshme të perimeve dhe pemëve.



Është diskutuar për rëndësinë dhe ndikimin e higjienës së pajisjeve në produkt, higjienën në vendin e punës, po ashtu detyrimet në përputhje me higjienën dhe standardet sanitare, komerciale, moral dhe obligimet ligjore. Gjatë trajnimeve është demonstruar në mënyrë praktike përpunimi i perimeve (sallatë e përzier, konservimi i kornishonit, feferonit, specit) dhe pemëve (përgatitja e xhemit të mjedrës, dredhëzës, vishnjës, manaferrës, kompot molle dhe dardhe) u janë dhënë sqarime edhe për produkte tjera për të cilat gratë kanë shprehur interesim, sidomos për rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe standardizimi i produktit si një çështje kyçe për një biznes të suksesshëm.

Edhe pse ishte viti i parë i punës për të dy grupet, ato arritën të përgatisin produkte mjaft cilësore dhe t'i promovojnë ato në panairët e organizuara nga Komuna e Vitisë.

Pjesëmarrësve në trajnim iu është shpjeguar për funksionin e secilës pajisje (duplikatorin, blurësen, pasterizatorin) si dhe rrezikun dhe sigurinë gjatë punës. Si pjesë e rëndësishme e trajnimit ka qenë mbajtja e shënimeve gjatë procesit të prodhimit e cila luan rol për zhvillimet e procesit por edhe mundësin e përmirësimit, po ashtu posedimin e të dhënave për sasinë dhe llojet e produkteve, kohën e prodhimit, personat përgjegjës etj.

2. Trajnimet në hortikulturë- Femrat luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e hortikulturës. Ato kryejnë detyra të ndryshme në hortikulturë, por nuk kanë qasje në trajnime të ndryshme në hortikulturë përveç trajnimeve të përpunimit. Për këtë qëllim janë organizuar nga 3 sesione trajnimi për 3 grupe të përfshira; gjithsej 56 gra janë trajnuar për prodhimin e perimeve, pemëve dhe bimëve mjekësore.

3. Trajnimet në blegtori- Puna e grave në mbarështimin e kafshëve është e rëndësishme. Në përgjithësi, gratë janë më të përfshira në prodhimin blegtoral veçanërisht për ripërtypësit e imët se sa në prodhimin e kulturave bujqësore. Gratë janë të përfshira shumë në pothuajse të gjitha aspektet e prodhimit blegtoral, me përjashtim të kullotjes dhe marketingut, pasi që këto detyra kërkojnë mungesën nga shtëpia. Aktivitetet për të cilat raportohet se gratë janë aktive janë: ushqyerja e kafshëve, përgatitja dhe grumbullimi i ushqimit të kafshëve, pastrimin e stallës, mjeljen e lopëve dhe përpunimin e qumështit. Prandaj, nga 3 sesione trajnuese janë organizuar për 3 grupe të grave; gjithsej 91 gra janë trajnuara në temat e lartcekura.

Pas përfundimit të trajnimit duke marrë parasysh gjendjen sociale në familjet e tyre dhe atyre që kanë nevojë për mbështetje në përcjelljen e trendit prodhues në bujqësi IADK ka përkrahur 9 gra me fidanë të specit, 4 gra me makina mjelëse dhe pako higjienike dhe një grua me serrë tharëse për bimë mjekësore.

Promovimi i produkteve

IADK ka ndihmuar përfitueset e projekteve, përpunueset në pjesëmarrje në panaire të ndryshme siç janë:

1. Panairi i produkteve bujqësore-MBPZHR dhe OEK – janë prezantuar produktet e 6 byfeve nga 24 gra.
2. Panairi regional “ Mitrovica 2016,7 gra cilat kanë bërë shitje të produkteve në vlerë prej 1,547.00 euro.

të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, standardizimin e produkteve, zinxhirin e vlerave të produkteve, marketingut në mënyrë të fuqizimit të grave në sektorin e agrobiznesit. Po ashtu janë zhvilluar.

Trajnimet në modulin e brumit - irk

Në sektorin e përpunimit shtëpiak, grupi i grave i përbërë nga 20 pjesëmarrës, është trajnuar në përgatitjen e ushqimeve. Gratë janë aftësuar në përgatitjen e recepturave të ndryshme në përgatitjen e ushqimeve tradicionale, si llokume, kiflet, petulla, bukë të llojeve të ndryshme, ëmbëlsira, etj. Ndërsa grupi i grave nga Komuna e Leposaviqit janë trajnuar në përpunimin e perimeve në 10 module të trajnimit dhe janë aftësuar në përgatitjen e 4 recepturave për përpunimin e perimeve. Grupet e grave kanë qenë nga komuniteti shqiptar dhe serb.



Përkrahja ne organizatat e ndryshme grave GRATË NË AGROBIZNES - GIZ

Edhe gjatë vitit 2016 është vazhduar bashkëpunimi në mes të IADK gjegjësisht departamentit të përpunimit me projektin e GIZ, projektit COSIRA-gratë në agrobiznes dhe OEK. Bashkëpunimi është zhvilluar për të trajnuar anëtarët e shoqatës së grave "Gjelbina", Komuna Vititrajnime për aftësitë në biznes dhe zhvillim të produktit në përgatitjen e ushqimeve të ndryshme, zhvillimit të produkteve



BASHKËPUNIMI IADK – HELP

Në kuadër të projektit të financuar nga organizata HELP, janë mbajtur trajnimet me tema të ndryshme në sektorin e kultivimit të drithërave, pemëve dhe perimeve. Po ashtu janë mbajtur edhe trajnime për përpunim të frutave dhe perimeve.

Pas përfundimit të trajnimeve për përpunim, së bashku me pjesëmarrësit është vizituar pika përpunuese në fshatin Frashër, Komuna Mitrovicë me qëllim që pjesëmarrësit të shohin në mënyrë praktike vendin e përpunimit, llojet e produkteve standarde që janë përgatitë në këtë pikë përpunuese të krijuara nga IADK gjatë vitit 2013.

IADK KOMUNËN E VUSHTRRIË - RRGGK

Nëpërmes aktiviteteve të projektit gratë kanë arritur të rrisin nivelin e avokimit të tyre tek institucionet përkatëse siç janë zyrat e punësimit dhe drejtoria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural. Në këtë projekt përveç fshatrave afër qytetit, janë synuar edhe fshatrat të cilat janë larg qytetit dhe në zona të thella malore, ku mundësia e kyçjes në avokim është e kufizuar për shkak të largësisë dhe shkollimit andaj projekti ka arritur që ky grup i grave të regjistrohen në zyrat e punësimit si mundësi për kyçje në shumë projekte nga donator dhe biznese të ndryshme.



Po ashtu si e arritur e rëndësishme e projektit ka qenë punësimi i 5 grave në bufet e shkollave të Komunës së Vushtrrisë, të cilat tani mund të krijojnë të ardhura për familjet e tyre.

BASHKËPUNIMI ME PARTNER PROFESIONAL INTERNACIONAL

Bashkëpunimi me organizatën holandeze PUM IADK është përfaqësuese e organizatës PUM për Kosovë në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit. Gjatë këtij viti janë angazhuar 6 ekspertë në sektorë të ndryshme në bujqësi me qëllim të përkrahjes së fermerëve në rritjen e prodhimtarisë dhe përmirësimit të kualitetit të produkteve bujqësore.



Në sektorin e blegtorisë gjatë vitit është angazhuar një ekspert nga organizata PUM. Gjatë këtij misioni fermerët janë trajnuar për parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, menaxhimin e fermës, dhe përmirësimin e kualitetit të ushqimeve voluminoze. Në këtë misioni është bërë vlerësimi i bashkëpunimit 3 vjeçar në mes IADK dhe PUM dhe janë analizuar mundësitë e vazhdimin të këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Në bazë të kërkesës nga sektori i përpunimit të ushqimit, gjatë këtij viti janë angazhuar 3 ekspert nga Holanda ku kanë punuar direkt në kompanitë “Apetit” – përpunimin e mishit, “Aldi” – në përpunimin e qumështit dhe “Agroflorentina” - në grumbullimin dhe shitjen e bimëve mjekësore. Ekspertët Holandeze së bashku me kompanitë përkatëse kanë punuar në ngritjen e cilësisë së produkteve përkatëse, zhvillimin e produkteve të reja dhe mundësinë e lidhjeve tregtare me vendet e EU.

Në sektorin e hortikulturës janë realizuar dy misione të ekspertëve të PUM-it, ku njëri mision ka të bëjë me bartjen e përvojave tek fermerët për bujqësinë organike, dhe tjetri për kultivimin, mbrojtjen dhe deponimin e patateve. Ekspertët e këtyre dy fushave kanë mbajtur trajnime me grupe të fermerëve në komuna të ndryshme të Kosovës, si dhe kanë dhënë këshilla direkte tek fermerët gjatë vizitave në teren.

Shkëmbimi i përvojave me organizatën AFDI nga Franca

Gjatë vitit 2016 IADK ka vazhduar bashkëpunimin me shoqatën AFDI në shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë. Gjatë këtij viti përfaqësuesit e AFDI-të kanë realizuar një vizitë në Kosovë. Qëllimi i vizitës ka qenë që t'u ndihmohet fermerëve në organizimin shoqatave të fermerëve, koordinimin aktivitetëve në sektorin e bujqësisë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi po ashtu një zyrtar/teknolog nga stafi i IADK-së ka qëndruar në Francë për një praktikë-kurs njëmuor në ferma të ndryshme ku bëhet edhe përpunimi i qumështit. Gjatë kësaj periudhe ajo ka pas rastin të ndjek në mënyrë praktike përgatitjen e 15 llojeve të ndryshme të produkteve të përfituara nga përpunimi i qumështit, duke përfshirë edhe përdorimin e frutave të ndryshme.



SHËRBIMERE KËSHILLIMORE ME KOMUNAT

Edhe gjatë këtij viti ka vazhduar bashkëpunimi me Komunën Vushtrrisë dhe Drenasit për ofrimin e shërbimeve këshillimore për fermerët në fusha të ndryshme të bujqësisë. Po ashtu këtë vit edhe Komuna e Vitisë ka nënshkruar marrëveshje me IADK-në për përkrahje të shërbimeve këshillimore për fermerët e kësaj komune.

Në Komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 8 sesione të trajnimeve me fermerë nga fusha e blegtorisë, pemëtarisë dhe perimeve, ndërsa janë kryer rreth 105 vizita/këshilla direkte në teren tek përfituesit e serrave, dredhëzave dhe mjedrave të shpërndara nga Komuna e Vushtrrisë.

Në Komunën e Drenasit janë mbajtur po ashtu 8 sesione të trajnimeve me fermerë nga fusha e blegtorisë, pemëtarisë, perimtarisë dhe përpunimit të frutave, ndërsa janë kryer rreth 185 vizita/këshilla direkte në teren tek fermerët nga sektori i pemëve, perimeve, përpunimit të frutave dhe ai i blegtorisë.

Në Komunën e Vitisë bazuar në marrëveshjen për përkrahje të shërbimeve këshillimore për fermerët e kësaj komune janë mbajtur 30 sesione të trajnimeve me fermerë nga sektori i gjedhtarisë, bletarisë, perimtarisë, pemëtarisë, përpunimit të pemëve dhe perimeve, si dhe në atë të kultivimit të bimëve mjekësore.

IADK “LABORATORI I AKTIVITETEVE TË BIZNESIT” (LAB)

IADK edhe gjatë vitit 2016 ka vazhduar bashkëpunimin me organizatën lokale “Laboratori për Aktivitete të Biznesit” (LAB), nga Hani i Elezit në kryerjen e shërbimeve profesionale për fermerë, në sektorin e bujqësisë dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për stafin e LAB-it. Gjatë këtij viti janë trajnuar fermerët në sektorin e hortikulturës në kultivimin e perimeve, frutave të imëta, pastaj në blegtori dhe bletari.

IADK MBPZHR

Edhe këtë vit IADK është përkrahur nga MBPZHR për të zbatuar projektin “Promovimi i kultivimit të mjedrës, mollës, dredhëzës dhe përmirësimi i kualitetit të qumështit”, e që ka të bëjë me mbajtjen e trajnimeve dhe vizitave në teren për

avancimin e njohurive të fermerëve në fushat përkatëse të bujqësisë. Projekti është shtirë në komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas, Lipjan, Obiliq, Viti, Zubin Potok, dhe Leposaviq. Gjithsejtë 170 fermerë të përfshirë në 17 grupe kanë ndjekur trajnime teorike dhe këshilla praktike në teren, për fushat përkatëse në të cilat zhvillojnë aktivitetet në fermat e tyre.

PËRGATITJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE DHE BIZNES PLANEVE

Në këtë vit janë përgatitur projekte të ndryshme për fermer dhe kompani të interesuara për aplikim të donatorë të ndryshëm. Po ashtu fermerët janë përkrahur me këshilla direkte varësisht nga kërkesat e fermerëve. Gjithsej janë përgatitur 6 projekt propozime për grante të ndryshme.

PUBLIKIMET

Gjatë vitit 2016 IADK ka përgatitur dhe publikuar 4 broshura dhe 19 fletëpalosje në të gjithë sektorët e bujqësisë.



Lista e broshurave të publikuara

	Titulli i publikimit	Sektori	Donatori
1	Përgatitja e ushqimeve tradicionale	Përpunimit	BfW
2	Programet e përshtatura të aftësimin profesional për përgatitje të ushqimit për bufetë e shkollave	Përpunimit	EU
3	Kultivimi i mjedrës organike	Hortikulturë	BfW
4	Kalendari për bletari	Blegtori	BfW

Lista e fletëpalosjeve të publikuara

	Titulli i publikimit	Sektori	Donatori
1	Përgatitja e ushqimit në bye "Rilindja "Maxhunaj, Vushtrri	Përpunimi	BfW
2	Përgatitja e ushqimit në bye "Shote Galica "Runik, Skënderaj	Përpunimi	BfW
3	Përgatitja e ushqimit në bye "Deshmoret e Vitise" Viti	Përpunimi	BfW
4	Përgatitja e ushqimit në bye "Bafti Haxhiu" Viti	Përpunimi	BfW
5	Funksionalizimi i byeve ne shkolla ne kuadër te projektit	Përpunimi	EU
6	Bufeja në shkollën "Musa Hoti" në Mitrovicë	Përpunimi	EU
7	Bufeja në shkollën "FazliGrajqevci" në Mitrovicë	Përpunimi	EU
8	Bufeja në shkollën "2" në Vushtrri	Përpunimi	EU
9	Bufeja në shkollën "MustafëVenhari" në Vushtrri	Përpunimi	EU
10	Bufeja në shkollën "Shaban Jashari" Skënderaj	Përpunimi	EU
11	Bufeja në shkollën "AhmetDelia" Skënderaj	Përpunimi	EU
12	Bufeja në shkollën "AbedinRexha" në Turigevc, Skenderaj	Përpunimi	EU
13	Bufeja në shkollën "AliGashi" Drenas	Përpunimi	EU
14	Bufeja në shkollën "XheladinGashi-Plaku" Komoran, Drenas	Përpunimi	EU
15	Menaxhimi i fermës se dhive	Blegtori	CFLI
16	Përmirësimi i kualitetit të qumështit të dhisë	Blegtori	CFLI
17	Aftësimi profesional në sektorin e blegtorisë	Blegtori	BfW
18	Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi	Blegtori	EU
19	Fuqizimi Ekonomik dhe ngritja e kapacitetve të grave dhe vajzave në viset rurale në Komunën e Vushtrisë		RrGGK

Vizitat e stafit dhe vizitat me fermer gjatë vitit 2016

Nr.	Vendi	Datat	Nr.i ditëve	Nr.i Pjesëmarrësve	Sektori
1	Kosovë	16.02.2016	1	16	Blegtori
2	Kosovë	27.04.2016	1	13	Përpunim Ushqimi
3	Kosovë	27.09.2016	1	40	Menaxhim Biznesi
4	Kosovë	30.09.2016	1	38	Menaxhim Biznesi
5	Shqipëri	21-22.05.2016	2	4	Bordi i Drejtorëve te IADK-se
6	Shqipëri	23.09.2016	1	5	Përgjithshem
7	Mal te Zi	11.08.2016	1	3	Menaxhim Biznesi
8	Maqedoni	31.10-03.11.2016	4	1	Përpunim Ushqimi
9	Maqedoni	24-27.11.2016	4	1	Përpunim Ushqimi
10	Slloveni	06.06.2016	2	1	Menaxhment
11	Bosnje e Hercegovin	05-08.10.2016	3	1	Përpunim Ushqimi
12	Serbi	16.02.2016	1	1	Menaxhment
13	Serbi	28-29.11.2016	2	2	Përpunim Ushqimi

14	Ceki	02-06.05.2016	4	7	Përpunim Ushqimi
15	Francë	26-29.09.2016	4	1	Menaxhment
16	Suedi	01-08.10.2016	8	1	Menaxhment
17	Holandë	09-14.10.2016	5	1	Menaxhment
18	Austri	14-16.11.2016	3	1	Menaxhment
Totali			48	137	

Lista e stafit të iadk për vitin 2016

NR.	EMRI MBIEMRI	DEPARTMENTI	TITULLI I VENDIT TË PUNËS
1	ZENEL BUNJAKU	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
2	ESMA AZEMI	Financa ,Administratë	Udhëheqëse e departamentit të Financave, Logjistikës dhe Administratës
3	ARIANA PECI	Prokurim & Adminstrate	Zyrtare per Prokurim & Adminstrate
4	VLORA ZYMBERI	Prokurim & Adminstrate	Zyrtare per Prokurim & Adminstrate
5	ELHEME SHALA	Financa,Administratë	Asistente e Financave
6	GURSEL ARIFI	Blegtori	Projekt Menaxher
7	XHAVIT SHALA	Blegtori	Inxhinier i Blegtorise
8	MAGBULE HYSENI	Përpunim Ushqimi	Menaxhere e Projektit
9	HAFIZE VESELI	Përpunim Ushqimi	Inxhiniere e Përpunimit te ushqimit
10	HANUMSHAHE ZENELI	Përpunim Ushqimi	Asistente e Zyres
11	SYLEJMAN BUNJAKU	Hortikulturë	Inxhinier i larte i Perimtarise
12	SKENDER FEJZULLAHU	Hortikulturë	Inxhinier i Bujqësisë – Pemëtari
13	NOVICA MARKOVIC	Hortikulturë	Inxhinier i Bujqesise
14	PETRIT KOCI	IT/Administratë	Mirembajtes i rrjetit/sistemit
15	FEHMI BASHOLLI		Kujdestar i objektit
16	SHKURTE BUNJAKU		Asistente e Zyrës&Asistente teknike
17	QENDRESA KURRUMELI		Asistente fushore
18	AFRIM SYLEJMANI		Asistent fushor
19	EDITA MAHMUTI	Menaxhere e Projektit	Menaxhere e Projektit
20	FIKRIJE FERIZI		Kordinatore Projektit
21	HAMIDE MAXHUNI		Asistente e Projektit

LISTA E PRAKTIKANTËVE NË VITIN 2016

NR.	EMRI MBIEMRI	DEPARTMENTI
1	EGZON GERXHALLIU	Praktikant&Ndimës ne përgatitjene e projekteve
2	PREMTIM KRASNIQI	Praktikant
3	BLETA HAJDINI	Praktikante - Hortikulture
4	ELBË JASHARI	Praktikante
5	FATON PACI	Praktikant - Financa
6	FITORE MEHMETI	Praktikante - Financa
7	FORTIANA KOVAQI	Praktikante - Financa


VULLNETARET PËR VITIN 2016

NR.	EMRI MBIEMRI	DEPARTMENTI
1	VALBONA ADEMI	Vullnetare për organizim të takimeve
2	GONXHE DOBROSHI	Vullnetare për organizim të takimeve
3	ARIFE GASHI	Vullnetare për organizim të takimeve
4	FATBARDHA TAHIRI	Vullnetare për organizim të takimeve
5	VAHIDE FAZLIU	Vullnetare për organizim të takimeve

Të hyrat e IADK-së nga Donatorët për vitin 2016

	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma € për 2016	Përqindja %
1	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë	Fuqizimi Ekonomik dhe ndërtimi i kapaciteteve të grave te veja ne regionin e Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Pristina	130,004	22.5%
2	Komunat (Vushtrri, Mitrovicë, Drenas), Skenderaj)		3,420	0.6%
3	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë	Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi	83,000	14.3%
	Komuna e Deçanit dhe Fermerët		30,814	5.3%
4	Bukë për Botën	Gjenerimi i të ardhurave dhe aktivitet trajnuese për grupet e marginalizuara dhe fermerët në zonat rurale	136,530	23.6%
	Komunat (Vushtrri, Mitrovicë, Drenas), Fermerët		28,617	4.9%
5	UNDP	Mbështetja e prodhimit vendor në Rajonin e komunave veriore në Mitrovicë dhe rajoni Ekonomik Jug	125,469	21.7%
	Fermerët		10,133	1.8%
6	Ambasada Kanadeze	Krijimi i kushteve të punës në zonat rurale dhe rritja e bashkëpunimit në mes të komuniteteve	16,439	2.8%
	Fermerët dhe tjera		2,832	0.5%
7	Ambasada Kanadeze	Rritja e ndërgjegjësimit dhe nxitja e përdorimit të energjisë alternative në bujqësi për të rritur qëndrueshmërinë e mjedisit dhe rritjen e gjelbër ekonomike	950	0.2%
8	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës	Fuqizimi ekonomik dhe ngritja e kapaciteteve të grave në vise rurale në komunën e Vushtrisë	6,990	1.2%
9	MBPZHR	Promovimi i kultivimit të mjedres, dredhëzës dhe përmirësimit i kualitetit të qumështit	3,500	0.6%
	Gjithsej		578,696	100%


Koment: Te gjitha te hyrat e paraqitura jane te hyra qe jane njohur gjate vitit 2016, perfshirë edhe të hyrat e shtyera nga viti 2015



Të hyrat e IADK-së nga Partnerët për vitin 2016

	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma € për 2016	Përqindja %
1	GIZ	Trajnime për fermerë	11,472	21.8%
2	HELP	Trajnime për fermerë	4,706	8.9%
3	Islamic Relief of Kosova	Trajnime për përpunim të ushqimit	1,486	2.8%
4	LDF	Trajnime ekonomike	958	1.8%
5	Komuna e Drenasit	Projekte dhe shërbime për fermerë të Komunës së Drenasit	19,156	36.4%
6	Komuna e Vitisë	Projekte dhe shërbime për fermerë të Komunës së Vitisë	1,564	3.0%
7	Komuna e Vushtrrisë	Projekte dhe shërbime për fermerë të Komunës së Vushtrrisë	4,293	8.2%
8	LAB	Ngritja e kapaciteteve të organizatës LAB dhe trajnime për fermerë	2,466	4.7%
9	AFDI	Vizitat studimore të fermerëve në Francë	1,000	1.9%
10	PUM	Ekspertizë nga eksperte të Holandës	2,000	3.8%
11	ALBINSPEKT	Trajnime lidhur me rregullimin e OJQ-se	600	1.1%
12	Te hyrat tjera	Te hyrat e ndryshme për shërbime të fermerëve, kompanive etj....	2,954	5.6%
	Gjithsej		52,655	100%

Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2016





Adresa:
Sfaraqak i Ulët
42000 Vushtrri
Kosovë/a

E-mail: info@iadc.org
Tel: +377 (0) 44 777 036
Web: www.iadc.org